



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

Tiranë, më 30.04.2021

Dokument parlamentar

RAPORT

(Komision për dhënie mendimi)

PËR

AKTIN NORMATIV

NR. 18, DATË 14.04.2021

“PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.137/2020, “PËR BUXHETIN E VITIT 2021”, TË NDRYSHUAR”

HYRJE

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut (*Komisioni për Çështjet Ligjore, - këtej e tutje*), në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 30.04.2021, mori në shqyrtim Aktin Normativ nr. 18, datë 14.04.2021 “Për disa ndryshime në ligjin nr.137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar”.

Komisioni për Çështjet Ligjore, caktoi relatore për shqyrtimin e këtij projektligji deputeten Vasilika Hysi.

Në mbledhjet e Komisionit për të mbrojtur projektligjin dhe për të dhënë shpjegime për pyetjet e anëtarëve të Komisionit ishin të pranishëm Znj. Adela Xhemajli, Zevendës ministre e Financave dhe Ekonomisë dhe znj. Mimoza Dhëmbi.

I. BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT

Akti normativ i propozuar për miratim, është akt normativ me fuqinë e ligjit, i nxjerrë në bazë të nenit 101 të Kushtetutës, i cili përcakton se Këshilli i Ministrave, në rast nevojë dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit.

Akti normativ shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

II. QËLLIMI I PROJEKTLIGJIT DHE PËRMBAJTJA E TIJ

Një nga përparësitë e qeverisë shqiptare, në mbështetje të sugjerimeve të ekspertëve të OBSH-së dhe Komitetit të Ekspertëve, është vaksinimi masiv i popullatës si e vetmja përgjigje ndaj virusit COVID -19 në një kohë sa më të shpejtë. Kjo përparësi është në përputhje edhe me prioritetet e përcaktuara në Strategjinë Kombëtare të Vaksinimit. Sipas kësaj strategjie, për të arritur imunizimin e të gjithë popullatës është vendosur si objektiv vaksinimi i 2.2 milionë personave, për të cilët nevojiten 4.4 milionë doza vaksinash.

Sipas informacionit të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS-së), deri me sot qeveria shqiptare ka nënshkruar kontrata për sigurimin e 2.2 milionë dozave të vaksinave. Ndërkohë që, për përmbushjen e objektivit të imunizimit ndaj Covid-19 kërkohen dhe 2.2 milionë doza të tjera vaksine, që, duke marrë parasysh çmimet e vaksinave, do të kërkonte një shtesë në buxhetin e MSHMS-së prej 2 miliardë lekësh të dedikuar për vaksinat.

Sipas nenit 3, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Fond rezervë” është fondi, që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara, në fazën e përgatitjes së buxhetit dhe, sipas nenit 5, të po këtij ligji, ky fond përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave.

Sipas përfaqësues së Ministrisë së Ekonomisë dhe Financave, akti normativ nuk prek parametrat kyçë makrofikalë, siç janë: deficitin buxhetor dhe borxhi publik, të cilët mbeten të pandryshuar. Akti normativ përcakton vetëm një ndryshim, i cili konsiston në shtesën me 2 miliardë lekë në fondin rezervë të Këshillit të Ministrave me qëllim përballimin e shpenzimeve të blerjes së vaksinave gjatë vitit 2021, si edhe të shpenzimeve të tjera eventuale të qeverisë që lidhen me pandeminë Covid-19.

III. VLERËSIMI I KUSHTETUTESHMËRISË SË AKTIT NORMATIV

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut si komision dhënie mendimi vlerëson nëse akti normativ është në përputhje me Kushtetën e Republikës së Shqipërisë.

Gjatë shqyrtimit të projektligjit në Komision nga relatorja znj. Hysi u vlerësua ndërmarrja e kësaj nisme ligjore, në mbështetje të sugjerimeve të ekspertëve të OBSH-së se vaksinimi masiv i popullatës dhe nevojës.

Neni 101 i Kushtetutës parashikon të drejtën e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte rregullatore me fuqinë e ligjit. Kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta e ka kushtëzuar ushtrimin e saj me ekzistencën e nevojës dhe urgjencës si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti, si dhe me kontrollin përfundimtar nga Kuvendi të akteve të nxjerra.

Akti normativ me fuqinë e ligjit është një instrument që ka për qëllim përshpejtimin e procedurave për nxjerrjen e ligjit, në mungesë të kohës së nevojshme për të filluar një procedurë normale të miratimit të një propozimi për të ndryshuar ligjin.

Akti normativ nr.18, datë 14.04.2021 propozohet në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës. Në këtë dispozitë kushtetuese parashikohet që Këshilli i Ministrave ka të drejtën e nxjerrjes së këtyre akteve normative me fuqinë e ligjit.

Akti normativ, gjithashtu, plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimet nr.24, datë 10.11.2006; nr.23, datë 16.4.2014 etj. Konkretisht, për miratimin e një akti normativ kërkohet të plotësohen kushtet që vijojnë:

- a) Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit;
- b) Përkohshmëria e masave që përmban akti normativ me fuqinë e ligjit;
- c) Fuqia ligjore e këtyre akteve dhe kufizimet për nxjerrjen e tyre;
- ç) Miratimi i aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Kuvendi.

Në cilësinë e relatores, znj. Vasilika Hysi analizoi nëse kushtet e përcaktuara në Kushtetutë janë të plotësuara në aktin normativ objekt shqyrtimi në Komisionin për Çështjet Ligjore.

Nevoja dhe urgjenca si kushte për nxjerrjen e aktit normativ me fuqinë e ligjit

Neni 101 ka parashikuar nevojën e urgjencën si rrethana dhe situata fakti që vlerësohen rast pas rasti. Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë procesin dhe ka përgatitur skenarin e rishikimit të buxhetit 2021, pasi ka marrë dijeni për kërkesën nr.1801, datë 12.4.2021, të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS). Përmes kësaj shkrese, MSHMS-ja paraqet kërkesën për fonde shtesë në masën rreth 2.4 miliardë lekë, me qëllim financimin e kryerjes së pagesave për sigurimin e vaksinave të nevojshme për përballimin e situatës pandemike.

Nisur nga sa më sipër, ky rishikim i buxhetit 2021 propozohet t'i nënshtrohet procedurës së aktit normativ, aspekt i nevojës dhe emergjencës të të cilit lidhet pikërisht me nevojën urgjentepër sigurimin e fondeve buxhetore në fjalë, përmes fondit rezervë të buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

Përkohshmëria e aktit normativ

Akti normativ vepron me fuqinë e ligjit për një periudhë kohe, maksimalisht 45ditë. Përkohshmëria e këtij akti normativ lidhet me kushtin e domosdoshmërisë së shqyrtimit të tij nga Kuvendi, i cili, nëse e miraton, e kthen atë në ligj. Për këtë arsye, menjëherë pas miratimit të aktit normativ me fuqinë e ligjit nga Këshilli i Ministrave, ky projektakt u dërgua për miratim në Kuvend, me qëllim fillimin e procedurave parlamentare përkatëse.

Gjykata Kushtetuese, në rastet e shqyrtimit të kushtetutshmërisë së akteve normative, ka konsideruar se e drejta e Këshillit të Ministrave për të nxjerrë akte normative me fuqinë e ligjit, sipas parashikimeve të nenit 101 të Kushtetutës, përbën një përjashtim nga parimi kushtetues i njohjes dhe përqendrimit të pushtetit ligjvënës në duart e Kuvendit të Shqipërisë, duke lejuar nxjerrjen e akteve me fuqinë e ligjit edhe nga organe të tjera kushtetuese.

Sic u theksua edhe më sipër, kjo e drejtë ka natyrë lejuese dhe përjashtimore, prandaj Kushtetuta, nëpërmjet nenit 101 të saj, i ka njohur të drejtën Këshillit të Ministrave të nxjerrë

akte normative që kanë fuqinë e ligjit vetëm kur rasti shfaqet si i jashtëzakonshëm dhe nevoja e urgjenca bëjnë të pamundur ushtrimin e kompetencës ligjvënëse nga Kuvendi (sipas vendimit nr.24, datë 10.11.2006, të Gjykatës Kushtetuese).

Akti Normativ që po shqyrtojmë vlerësohet se është një akt që del pikërisht në kushtet e nevojës dhe të urgjencës dhe i plotëson të gjitha kriteret e analizuara nga Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, veçanërisht vendimi nr.24 datë 10.11.2006, vendimi nr.23 datë 16.4.2014, etj ai dhe ka karakter të përkohshëm.

Komisioni për Çështjet Ligjore e shqyrtoi aktin normativ brenda afatit kushtetues dhe atij të përcaktuar në rregulloren e Kuvendit.

Gjatë diskutimit, Komisioni për Çështjet Ligjore mbështeti qëndrimin e relatores për të krijuar kushtet për të vaksinuar popullatën në tërësi si dhe e vlerësoi projektligjin shumë të rëndësishëm dhe në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

IV. PËRFUNDIME

Në përfundim të shqyrtimit të këtij projektligji, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

Në aspektin ligjor, vlerësoj se projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi.

Në aspektin procedural, projektligji është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, votoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe me shumicën e votave, e miratoi atë dhe u shpreh dakord për kalimin e këtij projektligji për miratim në seancë plenare.

RELATORE

KRYETARI

VASILIKA HYSI

ULSI MANJA